

PROCESVERBAL 24/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 3 (tretë) për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 24.03.2023 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten në shfrytëzim në vitin fiskal 2023 ;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Shirokë;
3. Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022,të barten në shfrytëzim në vitin fiskal 2023 ;

Avni Bytyqi - jeni të informuar që çdo vit bëhet bartja e mjeteve nga viti paraprak në vitin vijues për arsye se janë tre muajt e fundit të vitit 2022 që nuk kemi mundur ti shpenzojmë për shkak të mbylljes së sistemeve dhe nuk lejohet të bëhej alokimi dhe shpenzimi i këtyre mjeteve.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Shirokë;

Avni Bytyqi - është një kërkesë e lagjes në Shirokë në bashkëpunim me këshillin e bashkësisë islame në Suharekë që të caktohet nga Kuvendi i Komunës një lokacion për ndërtimin e xhamisë,për arsye se ata kanë thënë që kanë një donacion për ndërtimin e xhamisë.Janë nda 12 ari dhe sipas HZK-së PZHK-së i plotëson të gjitha kushtet.

Kresuesi - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet

Pika 4. Të ndryshme;

Kryesuesi - dua të ju njoftoj rreth përgjigjes që kam marrë nga Kryetari sa i përket kërkesës që e kemi bërë bashkarisht vitin e kaluar. Nga ky komunitet ka dalë një propozim sa i përket zyrës komunale për komunitete për shtimin e një punëtori në atë zyre. Përgjigja ka të bëjë për planin e Komunitetit në të ardhmen. Nëse ajo zyre kërkon ose fillojnë procedurat për një punëtor të ri atëherë Komuna do ta ketë parasysh në këtë aspekt për personat që vijnë nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian. Në bazë të rregullores Kryetari duhet ta dërgoj procedurën në MAPL por jo me kthyer përgjigje vetanake. Unë si Kryesues do ta bëj edhe një kërkesë dhe jo me na kthyer përgjigje personale.

Avni Bytyqi -si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë se është ekskluzivisht kompetencë e Kryetarit ta bëjë organizimin e brendshëm të administratës. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Takimi përfundoi: 09:15